



---

## OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

### DREJTORIA TEKNIKE

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

*(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)*

**BOE “InfoSoft Office” sh.p.k & “INTERLOGISTIC” sh.p.k**

**Adresa:** Tirane Kashar Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar** (marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues).

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti III "Blerje letër", me Nr. REF-13603-07-18-2024 për nevoja të Autoritetit Kontraktor përfitues Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

**Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** Deri në 24 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër. Lëvrimi/dorëzimi i mallit për lotin e tretë do të bëhet brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës/kontratave brenda marrëveshjes kuadër nga autoritetet kontraktore përfituese.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini Nr. 40 datë 22 Korrik 2024

Publikimet e mëparshme (*njoftimi i fituesit paraprak*): Buletini Nr. 70 datë 21 Tetor 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

- **BOE “InfoSoft Office” sh.p.k me NUIS J62426002Q dhe “INTERLOGISTIC” sh.p.k me NUIS K21605003M**

Vlera e ofertës pa tvsh = 25,512,600 (njëzet e pesë milion e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k,** **NUIS K81503063B**

Vlera e ofertës pa tvsh = 18,058,800 (tetëmbëdhjetë milion e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH

- **Operatori ekonomik “KRISTALINA.KH” sh.p.k** **NUIS K11501002D**

Vlera e ofertës pa tvsh = 0 (zero) lekë pa TVSH

- **Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k,** **NUIS L91418502J**

Vlera e ofertës pa tvsh = 21,210,000 (njëzet e një milion e dyqind e dhjetë mijë) lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k,** **NUIS L91418502J**

Për arsyet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin e pikës 3.2 të **Seksionit 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike** së DST ku përcaktohet se: ***Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 250 (dyqind e pesëdhjetë) ditë.***  
Operatori ekonomik, ka paraqitur sigurimin e ofertës me periudhë vlefshmërie 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë duke mos e plotësuar këtë kriter. OE skualifikohet pasi nuk përmbush të gjitha kushtet dhe kërkesat për kualifikim
- Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.6 pasi skeda teknike e paraqitur nuk plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konkretisht:
  - Nuk plotëson standardin për specifikimin teknik të përcaktuar ku kërkohet *që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë sipas ISO-s 9706.* Në dokumentacionin e paraqitur nuk vërtetohet që artikulli i paraqitur e plotëson këtë kërkesë.
  - Nuk plotëson specifikimin teknik të dukshmërisë e cila në specifikimet teknike është kërkuar të jetë >94%, ndërkohë që referuar specifikimeve teknike të paraqitura rezulton se dukshmëria e artikullit të ofruar është >92%.

2. **Operatori ekonomik “KRISTALINA.KH” sh.p.k** **NUIS K11501002D**

Për arsyet e mëposhtme:

**-Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument kualifikues në lidhje me dokumentet e tenderit.**

• **Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k,**

**NUIS K81503063B**

Për arsyet e mëposhtme:

Në zbatim të pikës 4, të nenit 82, të kreut X, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar Komisioni verifikoi sipas formulës së përcaktuar në dokumentet e tenderit, në qoftë se ofertat e vlefshme/kualifikuara janë anomalisht të ulëta, konkretisht kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlloritur.

**Zm = 75 % e Fondit limit = 75% e 28,003,442 = 21,002,581.5 lekë pa TVSH.**

Nga përlloraritja rezultoi se oferta e paraqitur nga OE “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k me NUIS K81503063B me vlerë 18,058,800 (tetëmbëdhjetë milion e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH është anomalisht e ulët..

Në këto kushte, referuar në parashikimet e nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 të ndryshuar, cituar:

*1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.*

*2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; 60 d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*

KVO më datë 25.09.2024 nëpërmjet SPE ju drejtua OE “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k. duke i kërkuar të paraqiste argumentim në përputhje me parashikimet e sipërcituara të LPP.

Më datë 30.09.2024 OE ka kthyer përgjigje nëpërmjet SPE duke paraqitur argumentet mbi ofertën anomalisht të ulët.

KVO nga shqyrtimi i materialeve dhe dokumenteve të paraqitur vlerëson se subjekti “ IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k.nuk e ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët për këto arsyet:

**“IT Gjergji Kompjuter” SH.P.K s’kualifikohet.**

-Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e Nenit 93 të ligjit nr.162/2020 pasi nuk arriti të argumentojë ofetën anomalisht të ulët , për shkak se dokumentacioni i paraqitur ka mangësi thelbësore në plotësimin e kushteve të kërkuara nga legjislacioni *a) argumentimin e anës ekonomike sipas zërave që përmban cmimi i ofertës së deklaruar; dhe b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*

Në shkresën e paraqitur me objekt "Sqarim oferte anomalisht te ulet" operatori ekonomik ka deklaruar se (ekstrakt i deklarimit)

a) "IT GJERGJI KOMPJUTER" është një kompani në rritje, me një eksperience 16 vjecare tashme në tregun e produkteve të IT, leter, tonera dhe kancelari.....

Ky është tenderi më i madh për leter që zhvillohet në vend për një afat 36 muaj. Për këtë arsye kemi bërë përpjekjet tona për të siguruar cmime konkurruese. Në këtë procedurë, kemi marrë pjesë me një marzh shumë të ulët fitimi, gjë që bënte që oferta jonë të rezultojë anomalisht e ulët.

b) IT GJERGJI KOMPJUTER, duke aplikuar cmime mjaft konkurruese, gjatë viteve të fundit ka fituar dhe realizuar me sukses disa procedurë prokurimi për leter, me institucione të rëndësishme, gjë që vërtetohet edhe me dokumentat e paraqitura në tender. ....

Etj.....

Referuar kushteve e përcaktuara në Nenin 93 të LPP, operatori ekonomik ka patur detyrimin të argumentojë ofertën duke sqaruar çdo element të përcaktuar nga kjo dispozitë e ligjit e konkretisht për:

*a) argumentimin e anës ekonomike sipas zërave që përmban cmimi i ofertës së deklaruar;*

*b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve;*

*c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*

*ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;*

*d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*

### **1.Arsyetimi për mosargumentim e kushtit**

***a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara ose të metodës së ndërtim/argumentimin e anës ekonomike sipas zërave që përmban cmimi i ofertës së deklaruar;***

Në lidhje me këtë kërkesë të ligjit mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, operatori ekonomik shprehet se ka bërë përpjekje që të sigurojë çmime konkurruese dhe me një marzh fitimi të ulët.

Në lidhje me këtë pjesë të argumentimit ekonomik të subjektit KVO konstaton se ky argumentim nuk qëndron pasi operatori nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion apo fakt (fatura apo kontrata bashkëpunimi me furnitorët) ku të evidentohet favorizimi apo zbritja preferenciale e pretenduar nga operatori ekonomik, si dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion apo argument nga ku të rezultojë marzhi i ulët i fitimit të pretenduar.

## **2.Arsyetimi për mosargumentimin e kushtit b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;**

Në lidhje me këtë kërkesë të ligjit mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, operatori ekonomik shprehet se b) IT GJERGJI KOMPJUTER, duke aplikuar cmime mjaft konkurruese, gjate viteve te fundit ka fituar dhe realizuar me sukses disa procedura prokurimi per leter, me institucione te rendesishme, gje qe vertetohet edhe me dokumentat e paraqitura ne tender Sjellim në vëmendje që kjo është një kontratë mallrash dhe e vetmja zgjidhje teknike e përfshirë është realizimi i lëvrimin. Nga dokumentat e shumta të paraqitura në tender shihet që kemi të gjitha kapacitetet (mjete tyransporti, punonjes) për të realizuar këto lëvrime

Në lidhje me këtë pjesë të argumentimit ekonomik të subjektit KVO konstaton se ky argumentim nuk qëndron pasi përsëri operatori nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion apo fakt shtesë (fatura apo kontrata bashkëpunimi me furnitorët) nga të cilat të evidentohet çmimet konkurruese të pretenduara nga operatori ekonomik.

## **3.Arsyetimi për mosargumentimin e kushtit c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;**

Në lidhje me këtë kërkesë të ligjit mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, operatori ekonomik shprehet se c) artikujt e letrës nuk kanë ndonjë kriter origjinaliteti.

Në këtë procedurë kemi kuotuar duke patur parasysh te gjitha alternativat e letrave të prodhuara nga firma Double A. Kjo, për arsyen se, kjo kontrate ka një afat 36 muaj dhe në këtë mënyrë, arrijmë të mbajmë cmimin e ulët të kuotuar.

Në lidhje me këtë pjesë të argumentimit ekonomik të subjektit KVO konstaton se ky argumentim nuk qëndron pasi edhe në këtë rast operatori nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion apo fakt shtesë (fatura apo kontrata bashkëpunimi me furnitorin e deklaruar).

Për sa më sipër, mbështetur në dokumentet administruara, përcaktimet në DST dhe në mbështetje të nenit 93 pika 2 të ligjit të ligjit nr.162/2020, të ndryshuar dhe arsyetimet e parashtruara më sipër, KVO në mënyrë përfundimtare vlerëson se **operatori ekonomik nuk e ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët dhe vendos të mos e pranojë ofertën e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k me NUIS K81503063B.**

Duke iu referuar procedurës së mësipërme meqënëse procedura është marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, **ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues** ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si operator ekonomik i sukseshëm

- **BOE “InfoSoft Office” sh.p.k me NUIS J62426002Q dhe “INTERLOGISTIC” sh.p.k me NUIS K21605003M**

Vlera e ofertës pa tvsh = 25,512,600 (*njzet e pesë milion e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind*) lekë pa TVSH.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Operatori i Blerejeve të Përqëndruara sha brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen kuadër.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO X

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)\_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO